



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**NGA DËGJIMI PUBLIK I KOMISIONIT PËR LEGJISLACION,
TË MBAJTUR MË 22.02.2017**

SHKURT
2017

Mbledhjen e drejtoi zëvendëskryetarja e Komisioni për Legjislacion, z. Selvije Halimi

KRYESUESJA Selvije Halimi: Përshëndetje, Zonja Tahiri, Përshëndetje zonja Hoxha, Përshëndetje për anëtarët e Komisionit, Shoqërinë civile dhe mediat, Paraprakisht ju falënderoj për kohën që keni gjet të jemi bashkë në Komisionin për Legjislacion dhe ne kemi menduar si Komision që sot të zhvillojmë një diskutim dhe të kemi një informim pak më detal lidhur me zbatimin e marrëveshjes për drejtësinë.

Për këtë çështje fillimisht ia japi fjalën zonjës ministre Edita Tahiri, e më pastaj shkojmë edhe me ministren e Drejtësisë. Faleminderit!

MINISTRJA EDITA TAHIRI: Faleminderit, e nderura kryesuese!

Të nderuar anëtarë të Komisionit për Legjislacion,

E nderura ministre Hoxha,

Ju përshëndes të gjithëve,

Dhe ju falënderoj për ftesën që sot së bashku me ministren e Drejtësisë të jemi këtu me juve dhe të diskutojmë për rrjedhat dhe rezultatet e Marrëveshjes së Brukselit në fushën e drejtësisë, e cila marrëveshje ka një rëndësi shumë të madhe për Republikën e Kosovës sepse mundëson konsolidimin e sistemit unitarë të drejtësisë edhe në pjesën veriore të vendit e cila ka qenë e kontestuar sidomos pas pavarësisë së Kosovës.

Mirëpo struktura paralele në fushën e drejtësisë ka ekzistua gati që nga përfundimi i luftës dhe që janë toleruar nga UNMIK-u në atë kohë, pastaj ne kemi bërë përpjekjet Qeveri pas Qeverie por nuk ka pasur ndryshime.

Prandaj, dialogu i Brukselit ka mundësuar që të ndodh shuarja e strukturave ilegale të gjykatave dhe të prokurorisë. Pastaj kemi punuar në procesin e integritetit apo të punësimit të ish gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë në institucionet e Drejtësisë së Republikës së Kosovës si dhe kemi përfunduar të gjitha proceset që kanë të bëjnë me zbatimin e kësaj marrëveshje që nuk është një proces i lehtë për arsye se rekrutimi i tyre është bërë në bazë të ligjeve të Republikës së Kosovës por edhe një gjykatë themelore do të rikonsolidohet është gjykatë themelore sipas ligjeve të Kosovës vepron për regjionin e Mitrovicës dhe për shtatë komuna ashtu siç e thotë ligji përkatës i Kosovës si dhe Zyra e Prokurorisë po ashtu është për shtatë komuna

pra këto janë të nivelit themelor siç i kemi të organizuara gjykatat e për të cilat e kemi ministrin, unë mund të tingëllojë profesioniste por jo vetëm që jam marrë me këtë çështje.

Unë kisha dashur që të ju njoftoj pak më hollësisht për gjithë këto procese në mënyrë që të merrni informacionin e dorës së parë dhe pastaj flasim edhe për aspektet tjera që ju interesojnë juve.

E para, të ju japë disa informacione ku buron marrëveshja e drejtësisë. Marrëveshja e drejtësisë buron nga ligji për ratifikimin e marrëveshjes për normalizimin e marrëdhënieve mes dy shteteve me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian i datës 19 prill 2013, ku neni 10 i këtij ligji i referohet pra vendosjes së ligjshmërisë në fushën e drejtësisë edhe në komunat veriore dhe në bazë të kësaj marrëveshje e cila është arritur në nivelin e lartë politik të kryeministrave të dyja shteteve dhe zonjës Eshton e cila në atë kohë ishte përfaqësuese e lartë e Bashkimit Evropian janë përcaktuar qartë se në Kosovë duhet të shuhen strukturat paralele të Serbisë në fushën e drejtësisë, natyrisht ka edhe shuarje të strukturave paralele edhe në fusha tjera aty ku janë arritur marrëveshjet dhe ku janë zbatuar dhe që kjo i ka hapur rrugë që këta ish gjyqtarë dhe prokurorë që dikur kanë vepruar kundër sistemit dhe rendit kushtetuese të Kosovës të braktisin veprimtarinë ilegale dhe të pranojnë të punësohen apo të integrohen në gjyqësinë e Kosovës.

Për këtë qëllim siç ju kujtohet ne edhe kemi miratuar Ligjin për amnisti e cila vlen për gjithë qytetarët e Kosovës por veçmas është edhe për këta persona që të ndjehen pra të themi komod për të braktisur veprimtarinë ilegale dhe për tu bërë pjesë e shtetit të Kosovës dhe për të punuar për ardhmërinë e shtetit tonë.

Pastaj, krahas kësaj marrëveshje ka pasur edhe një marrëveshje tjetër e cila e detalizon marrëveshjen e parë është sikur një plan zbatimi po ashtu i miratuar në nivel të kryeministrave dhe të përfaqësueses së lartë Mogerini dhe janë disa konkluzione të cilat në një mënyrë janë plane shtesë zbatuese për të shpjeguar gjithë procesin.

Unë do të mundohem së pari është shumë me rëndësi të themi që si është bërë procesi i rekrutimit sepse besoj që shumë edhe kam pasur pyetje nga gazetarë apo deputetë dhe është tepër me rëndësi që të bëjë shpjegimin dhe nuk është vetëm në drejtësi por edhe në fusha tjera kur kemi bërë integrimin apo punësimin e pjesëtarëve të komunitetit serbë ka pasur kritere të caktuara dhe që kanë shkuar praktikisht në një mënyrë shumë të sistemuar dhe kanë qenë të infolvuar të gjitha institucionet e drejtësisë së Republikës së Kosovës prej Ministrisë së Drejtësisë,

Këshilli Gjyqësorë i Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës më përpara kanë qenë institucionet tjera nuk kanë qenë këto po ka qenë ekipi i kryeprokurorit të shtetit, pastaj Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Gjykata e Apelit, pra të gjitha këto kanë qenë të involvuara.

Tani për sa i takon kriterëve unë mund të ju them se në kriterë janë paraparë gjërat kryesore janë që ai që dëshiron të punoj në institucionet e Kosovës duhet të disponojë me lejen e njoftimit të Republikës së Kosovës, duhet t'i plotësoj kriteret profesionale, duhet t'i ketë të kaluarat të gjitha ato kualifikimet profesionale, pastaj duhet të jetë lejal ndaj institucionit duke marrë parasysh drejtësinë si një vlerë universale por edhe një obligim kushtetues dhe ligjor në raport me qytetarët dhe shtetin e Kosovës.

Natyrisht janë përzgjedhur të tillët të cilët nuk kanë pasur ndonjë ndeshje me ligjet në Kosovë e të tjera. pra, që kriteret që specifikohen me ligjet e Kosovës.

Integrimi është bërë në dy faza, faza e parë ka përfshirë një pjesë të tyre në bazë të konkursit por me qenë se nuk ka pasur interesim të mjaftueshëm për tu punësuar apo integruar është dashur të bëhet e faza e dytë e konkursit por edhe e rekrutimit është krijuar paneli i cili natyrisht është bërë me ligjet e Kosovës ku Ministria e Drejtësisë por edhe gjithë aktorët gjyqësor të shtetit tonë kanë qenë të përfaqësuar.

Në gjithë këtë proces ne kemi qenë të mbështetur nga Bashkimi Evropian, por edhe EULEX-i ka dhënë ndihmën e vetë, duhet të kemi parasysh pse ndihma, sepse ka qenë një raport krejt i çrregulluar në raport me këta njerëz të manipuluar nga Serbia kanë punuar kundër shtetit të Kosovës dhe natyrisht krijimi i masave të mirëbesimit ka ndodhë edhe falë aktorëve ndërkombëtarë.

Këtu dëshiroj të përmend edhe kontributin e Qeverisë Amerikane por edhe Ambasadës Amerikane e cila bashkë me ministren edhe me mua janë edhe gati në grupin punues që punojmë në zbatim, pse duhet sepse ka raste kur pa ndërhyrjen e ndihmës e Qeverisë Amerikane gjërat nuk kanë ecur aq lehtë.

Për sa i takon Gjykatës Themelore mund të ju njoftoj se kryetari i gjykatës do të zgjidhet përmes konkursit përsëri në bazë të ligjeve të Kosovës dhe do të jetë serbë për kah përkatësia etnike ndërsa zëvendëskryetari do të jetë shqiptarë, ndërsa kryetari i Zyrës së Prokurorisë Zyrës Themelore të Prokurorisë duhet të jetë shqiptarë ndërsa zëvendësi do të jetë serbë.

Në rastin e integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve serbë ne kemi bërë integrim për mbarë Kosovën, pra nuk është vetëm në raport me regjionin e Mitrovicës, arsyeja ka qenë që të reflektojmë dhe të zbatojmë ligjet tona që afirmojnë edhe një inkluzivitet etnik e që për një kohë kanë munguar në disa gjykata në Kosovës po e kemi integruar edhe institucione më të larta përfshirë Gjykatën Supreme, kemi Gjykatën Kushtetuese e tash e tutje do të jenë edhe nëpër gjykata themelore që janë të tjera pra përveç Mitrovicës.

Cilët do të jenë detyrat e tyre, do të jenë të njëjta siç edhe i ka secili gjykatës në raport me vendin e punës, në raport me obligimet që të shërbejnë drejtësinë pa ngjyrim pa dallime ashtu siç përcakton Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe ashtu siç përcaktojnë politikat e shtetit të Kosovës që vërtetë kanë qenë shumë të hapura ndaj minoriteteve.

Unë mendoj që Kosova është model në rajon për respektimin dhe integrimin e minoriteteve dhe siç e dini madje edhe në raport me minoritetin serbë ju kemi dhënë edhe të drejta më shumë se të tjerave kjo rrjedh nga plani i Ahtisarit që ka qenë e lidhur me gjithë atë plan me të cilin Kosova ka shpallur pavarësinë dhe sot po forcohet si shtet edhe në planin vendor edhe në planin ndërkombëtarë.

Ku do të jenë këto gjykata, do të jenë në Mitrovicë, do të ketë më së pari ndërtesa e mëparshme e Gjykatës themelore do të vëhet në funksion, pastaj do të ketë edhe disa komponenta në pjesën jugore, është ish ndërtesa e Jugobankës do të vëhet në dispozicion, janë marrë edhe lokale me qira në mëhallën e boshnjakëve dhe të gjitha komponentat e Gjykatës Themelore të regjionit të Mitrovicës dhe Zyrës së Prokurorisë së regjionit të Mitrovicës do të jenë të vendosura në këtë kompleks të ndërtesave.

Po ashtu është me rëndësi të thuhet që Gjykata themelore e cila ka vepruar në Vushtrri për rrethana të jashtëzakonshme dhe të imponuara tani të gjithë do të kthehen, pra do të jetë stafi i shqiptarëve, serbë edhe minoritete tjera.

Kur jam te minoritetet tjera kam qenë në një dëgjim publik në Komision për Punë të Jashtme, kam pasur reagime me vend nga përfaqësuesi i minoritetit boshnjak i cili mendon se kjo marrëveshje dhe marrëveshje tjera pak adresojnë çështjet e minoriteteve tjera apo komuniteteve.

Unë po them minoritete për me u kuptua se janë minoritete po në fjalor i komi komunitete.

Ajo që mund të ju them për minoritete tjera është kjo që institucionet e shtetit të Kosovës në atë natyrisht që do të angazhohen për të respektuar kriteret etnike por edhe politikat afirmative ndaj minoriteteve në mënyrë që aty ku do të shohin mungesë të tjerëve hiq minoriteti serbë do të angazhohemi shtesë dhe pse marrëveshja e Brukselit është marrë vetëm me integrimin pra e stafit serbë lidhur me faktin që Serbia kishte vendosur struktura paralele në Kosovë një kohë të gjatë dhe heqja e këtyre strukturave ka qenë e lidhur edhe me procesin çka do të ndodhë me njerëzit që punuan në ato struktura në mënyrë ilegale. Pra, ka qenë më tepër zgjidhja e një problemi pa hyrë në punët e brendshme të Kosovës në raport me minoritetet tjera.

Për fund ka edhe detale por besoj përmes pyetjeve do përgjigje.

Për fund dëshiroj të ju them shpesh ka pasur pyetje pse bisedohet në Bruksel thuaja për drejtësinë apo për policinë apo për fusha tjera.

Kam pasur edhe kritika këto janë punë të brendshme. këto vërtetë janë punë të brendshme kur ne kemi pasur ndërhyrjen e shtetit fqinjë ish okupatori i cili ka vendosur struktura ilegale në shtetin tonë dhe me që ne kemi zgjedhur rrugën e dialogut dhe nuk kemi dashur në mënyrë konfrontuese me i shuajt ato, atëherë u deshtë të bëhen bisedimet në Bruksel dhe ky proces përmes dialogut ka mundësuar shuarjen e policisë paralele që ka vepruar në veri që nga fillimi i vitit 2014 ish policiët tash janë pjesë e Policisë së Republikës së Kosovës, kemi shuajtur ish mbrojtjen civile që ka qenë strukturë paramilitare, kemi ...mbi 20 ministri dhe agjenci në komunat veriore jo lehtë me shumë pengesa por ne jemi të vendosur që procesi të kryhet për faktin që edhe kemi arritur marrëveshjet ndërkombëtare.

Pastaj kemi shuajtur dogana paralele, kanë vepruar në veri doganat paralele dhe ka pasur vula paralele të gjitha këto janë shuajtur nuk përdoren më vulat paralele.

Autoritetet shtetërore të Kosovës janë vendosur në dy pikë kalimet kufitare në Bërnjak dhe Jarinje që nuk kanë qenë për shumë vite. Pastaj kemi fusha tjera sikur vendosje e zyrave të regjistri civil dhe do të fillojmë dhënien e dokumenteve të shtetësisë për qytetarët sidomos serbë të pjesës veriore që kanë refuzuar më herët të marrin dokumentet e shtetit të Kosovës për shkak të ndikimeve negative të Serbisë por marrëveshja e Brukselit pra obligon ne të pajisim ata me dokumente të shtetësisë ndërsa interesimi mund të ju them është gjithnjë më i madh që të marrin dokumentet e shtetit që tregon një proces të normalizimit që është inkurajues nga jashtë ndonjëherë nuk duket e di që ka edhe zëra që thonë që nuk ka pasur kurrfarë progresi, s'ka nevojë me shkua në Bruksel e të tjera, po të mos kishte progres

sigurisht asnjë shtet nuk ka energji tepërt me shpenzua po ne shohim progres të prekshëm edhe shpesh unë nuk kam thënë ata që nuk i shohin këto duhet fakte, duhet fakte nëse e kundërshtojnë vetëm me fjalë nuk kundërshtohet këto janë procese të mëdha të rëndësishme që kanë të bëjnë me forcimin dhe konsolidimin e shtetit tonë.

Dhe e fundit, pse po vonohet marrëveshja. Ka qenë e paraparë të zbatohet më 10 janar të këtij viti.

Vonesa ka ardhur si rezultat i tensioneve që ndodhen në dy muajt e fundit e që kanë të bëjnë me provokime destabilizuese që Serbia i bëri ndaj Kosovës me synim që të cenoj sovranitetin e shtetit mirëpo opinioni publik edhe populli e dëshmoi që institucione shtetërore jo vetëm që mbrojtën sovranitetin e shtetit por edhe e kthyen mbrapsht atë tren provokativ e rrënuam murin.

Natyrisht jemi ende të brengosur për çështjen e liderit të AAK-së edhe njëri prej ish komandantëve të shquar të UÇK-së zotit Ramush Haradinaj edhe pse po mbrohet në liri ne kemi dëshirë dhe po punojmë intenzivisht. Mandej e keni pa që edhe presidenti Thaçi në samitin e sigurisë në Munih direkt me përfaqësuesit e Interpolit ka kërkuar që të ndalen fletëarrest ndërsa këto ditë edhe shteti Gjerman ka kërkuar nga Franca që të mbyllet më shpejt ky proces dhe ai të lirohet.

Ne jemi të bindur se ai do ta dëshmojë pra që është ai i cili nuk ka fajësi siç e ka dëshmuar edhe në Gjykatën e Hagës, mirëpo shqetësimi mbetet derisa mos ta shohim këtu në Kosovë.

Faleminderit, shumë edhe besoj që do të kemi kohë edhe për pyetjet.

KRYESUESJA: Faleminderit, zonja ministre!

Do të shkojmë edhe me një dëgjim nga Ministria e Drejtësisë, nga zonja Hoxha e më pastaj anëtarët e Komisionit do të bëjnë pyetje.

Zonja Hoxha e keni fjalën.

MINISTRJA DHURATA HOXHA: Ju faleminderit!

E nderuara nënkryetare e Komisionit, zonja Halimi,

E nderura ministre zonja Tahiri,

Anëtarë të Komisionit,

Të nderuar përfaqësues të shoqërisë civile që po i shoh këtu,

Të nderuar të pranishëm,

Së pari dëshiroj të ju falënderoj për ftesën për këtë dëgjim publik i cili i dedikohet çështjes së zbatimit të marrëveshjeve për funksionalizimin e Këshillit Gjyqësorë dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Është një temë e qëlluar sepse së fundi nëpër media gjithashtu edhe qytetarët kanë pasur shqetësimet e tyre në lidhje me këtë temë.

Dhe mendoj se është në funksion edhe të rritjes së besimit të qytetarëve në drejtësi që të dëgjojnë pra nga akterët kyç në këto procese pra respektivisht ministren për Dialog pastaj edhe Ministrin e Drejtësisë e cila në një mënyrë ka pasur rolin e vetë. Por, edhe pse Ministria e Drejtësisë ka pasur rol pra në këtë proces, gjithashtu duhet të theksojmë se roli i Ministrisë së Drejtësisë ka qenë mjaft i kufizuar jo për shkak të mungesës të vullnetit por për shkak se edhe Këshilli prokuroria edhe Këshilli Gjyqësor janë organe të pavarura, respektivisht me sistemin gjyqësor, janë organe të pavarura në ushtrimin e funksioneve të tyre.

Në lidhje me këtë çështje roli i Ministrisë së Drejtësisë ka qenë në drejtim fillimisht të organizimit të provimit të jurisprudencës për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës këtu duke përfshirë edhe të interesuarit apo gjyqtar, prokuror dhe bashkëpunëtorët profesional, të cilët kanë qenë të interesuar për tu integruar në sistemin gjyqësor apo prokurorial të Kosovës. Provimi është organizuar nga ministrja e Drejtësisë në pajtim me afatet e përcaktuara me Ligjin për dhënien e provimit të jurisprudencës. Pra, ka qenë afati i rregullt nuk ka qenë afat i jashtëzakonshëm, ka qenë afati i rregullt i shtatorit kur e kemi organizuar në afatin e fundit nga gjithsej 97 kandidatë sa kanë kaluar këtë provim, 9 prej tyre janë të komunitetit serbë. Në afatin e parafundit pra i cili ka qenë afati i shtatorit dhe i cili afat ka qenë ku shumica e kandidatëve kanë qenë pra kandidatë, të cilët janë persona të cilët do të integrohen.

Kanë kaluar 6 kandidatë të komunitetit serbë dhe kanë pasur kriteret e njëjta, kushtet e njëjta siç janë të përcaktuara me Ligjin për provimin e jurisprudencës dhe kanë pasur trajtim të barabartë sikur të gjithë kandidatët tjerë. Pra, kanë ardhur në provim i janë nënshtruar provimit, komisioni i ka pasur kushtet e njëjta sikur për të gjithë kandidatët tjerë.

Kjo është sa i përket pra pjesës ku Ministria e Drejtësisë ka qenë në mënyrë të drejtpërdrejtë e përfshirë në marrëveshjen për integrim. Gjithashtu, këtu dua të shfrytëzoj rastin të ju informoj se ne jemi të angazhuar edhe në përmirësimin e infrastrukturës që u përmend edhe nga ministrja Tahiri. Në këtë aspekt jemi në konsultime me kryeministrin dhe ministrin e Financave që të sigurojmë mjete

shtesë Këshillit Prokurorial për mbulimin e shpenzimeve për pagesën e qirasë, për objektin i cili do të vendoset prokuroria.

Gjithashtu, kemi biseduar edhe me Këshillin Gjyqësor edhe Këshillin Prokurorial që edhe ata t'i përfundojnë procedurat e tyre, sepse kuptohet të gjitha procedurat janë pra në kompetencën e Këshillit Prokurorial, gjegjësisht Këshillit Gjyqësor. Pra, Ministria e Drejtësisë nuk ka mandat apo kompetenca që të merret me lokacionet apo premiset fizike të gjykatave apo objekte të prokurorisë dhe gjithashtu këtu dua të shpreh përkushtimin e Ministrisë së Drejtësisë që në pajtim me përgjegjësitë dhe mandatin që kemi si ministri do të jemi të gatshëm të japim kontributin tonë në këtë drejtim dhe të ofrimin të kushteve sa më të mira për integrimin e këtij komuniteti në sistemin tonë të drejtësisë, kuptohet gjithnjë në pajtim me Kushtetutën dhe ligjet e Republikës së Kosovës.

Ndërsa, për një temë të ngjashme gjithashtu dua të ju informoj që së shpejti do të sjellim pra në Kuvend edhe një pako ligjesh që kanë të bëjnë me Këshillin Gjyqësor, Këshillin Prokurorial dhe disiplinimin apo përgjegjësitë disiplinore të gjyqtarëve, respektivisht prokurorëve dhe gjithashtu edhe të kryeprokurorit të shtetit. Pra, këtu kemi të bëjmë edhe me përmirësimin e standardeve të prokurorisë speciale apo kritereve për rritjen e numrit të prokurorëve në prokurori speciale.

Pra, këto janë disa shkurtimisht disa nga arritjet apo një raportim nga Ministria e Drejtësisë mirëpo i mirëpresim pyetjet e juaja dhe jemi këtu për pyetje shtesë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, ministre! Po, zonja Tahiri.

MINISTRJA EDITA TAHIRI: raportimi i ministres ka të bëjë me periudhën kur ajo e ka marrë përsipër këtë përgjegjësi, desha të ju informoj që që nga ditët e para kur ka filluar procesi i negocimit të marrëveshjes në Bruksel të udhëhequr nga kryeministri i Republikës së Kosovës, ministritë dhe institucionet që kanë qenë pjesë e grupit punues apo delegacionit të Republikës së Kosovës janë këto.

Pra, kryeministri, pastaj Zyra e Kryeministrit, Zyra e zëvendëskryeministrit në atë kohë që i bjen zyra ime si kryenegociatore, Ministria e Drejtësisë dhe ministri ka qenë i involvuar, kryeprokurori i shtetit, këshilli gjyqësor i Kosovës, Gjykata e Apelit, Gjykata Supreme e Kosovës dhe pastaj siç e thamë pas ndryshimeve kemi Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Këshillin Gjyqësor që zëvendëson ata që kanë qenë paraprakisht. Pra ky ka qenë grupi punues që ka përfshirë të gjithë aktorët e drejtësisë si delegacion që ka qenë në mbështetje të kryeministrit e ministrit të Drejtësisë dhe mua si kryenegociatore në dialogun e Brukselit.

KRYESUESJA: Faleminderit, zonja Tahiri! Tani është radha që anëtarët e komisioneve do të bëjnë pyetje për të dy ministrinë në rrafshin e përgjegjësive për secilën.

Para se të kalojë te anëtarët e komisionit, desha unë t'i bëj disa pyetje që më tepër i shoh si shqetësime qytetare për faktin që qytetarët dhe njerëzit, të cilët e shohin vetën dhe janë ndoshta edhe kompetentë të kësaj fushe shpesh dëgjojmë duke dhënë versione të ndryshme sa i përket marrëveshjes, ndoshta në mungesë të informacioneve, ndoshta në mungesë të apo mënyrës se si e shohin interpretimin e zbatimit të kësaj marrëveshje.

E para, për zonjën Tahiri: ministre ju shpesh deklaroni që shumë detaje të marrëveshjeve të lidhura në Bruksel e kanë fatin edhe me shuarjen e strukturave paralele, çka mendoni unë ju inkurajoj për një lloj kushtëzimi ta themi ashtu që e deklaroni edhe shihet qartë që po i përmbaheni kësaj, çka ju merr mendja deri kur mund të zgjat kjo faza e shuarjes në tërësi të strukturave ilegale në veri dhe një pyetje tjetër që kisha për të ju bërë tash është veç në fazën e transformimit apo bartjes së gjykatës nga Vushtrria në Mitrovicë, Gjykatës Themelore mirëpo ajo që më tepër do të isha ndalur ka të bëjë me strukturën e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Sipas marrëveshjes pozicionet menaxheriale të gjykatës dhe të prokurorisë janë ai raporti i kryetarit të gjykatës serbe dhe zëvendësi shqiptar, kurse te prokuroria e kundërta. Sa i përket strukturës së gjyqtarëve dhe prokurorëve ka diku ndonjë marrëveshje që strukturat duhen të jenë në favor të numrit shumicë të qytetarëve në pjesën veri apo kjo shkon sipas kriterëve kush i përmbush kushtet që të zgjidhet si gjyqtar, sepse ka diskutime të tilla. Nëse ka diçka të tillë së paku të kemi informacion.

Kurse për zonjën Hoxha, desha të ju pyes për veç tash ju domethënë prej kohës kur ju jeni drejtuese e Ministrisë së Drejtësisë, keni organizuar provimin e jurisprudencës sipas ligjit, përveç komunitetit serbë a keni edhe komunitete tjera që janë jo shqiptar dhe jo serbë dhe i nënshtrohen këtij provimi dhe a ka interesim prej tyre, sepse shpesh na ndodh neve që të dëgjojmë prej komuniteteve jo shqiptare dhe jo serbë që me të drejtë na adresohen se përgjithësi shumica e qytetarëve në Kosovë prioritet i jep edhe zbatimit të ligjeve edhe marrëveshjeve sa i përket komunitetit serbë, por më pak i përkushtohemi komuniteteve tjera që në parim ju jap të drejtë, mirëpo rrethanat e kanë bërë të vetën.

Por, sa është interesimi i tyre dhe a kemi raste kur edhe përkundër faktit që i plotësojnë kriteret këta mbesin anash po mendoj jashtë procesit në sistemin e drejtësisë. Pyetjet e mija më tepër u përqendrova në ato që ndoshta duken në dukje teknike, por që te qytetarët kanë peshë. Faleminderit!

Zonja Bajrami ka kërkuar fjalën ose zoti Zemaj.

VALDETE BAJRAMI: Faleminderit, nënkryetare!

Përsëritje për të gjithë,

Unë fillimisht dua të ndalem te zonja Tahiri pastaj me vazhdu ashtu siç edhe filloi takimi.

Zonja Tahiri, po ashtu edhe kjo marrëveshje sikur edhe marrëveshjet e tjera nuk ka qenë transparente edhe ju këtë e dini, dhe po ashtu nuk ka pas as publikime as në ueb faqen e kryeministrit. Unë dua të drejtoj një pyetje lidhur me fjalimin tuaj që e patët, si kjo marrëveshje dhe këta njerëz, të cilët kanë qenë ilegal tash në petkun e legal do të mund të garantojnë edhe do të punojnë për të ardhmen e Kosovës, si mundeni ju të garantoni për këta njerëz të cilët deri në momentin e fundit kanë punuar kundër interesave tona, kundër interesave të shtetit tonë, kundër interesave të shqiptarëve po të njëjtit pritni që të punojnë për interesat e shqiptarëve.

Tjetra, kjo gjykatë me këtë përbërje siç e pamë ishte shumica serbe dhe shumë pak kishte shqiptarë. Çka do të bëhet me komunitetet tjera a do të përbën shkelje të të drejtave të komuniteteve të tjera kjo gjykatë me këtë përbërje dhe a ka mundësi që ndoshta komunitetet tjera të shtrojnë kërkesë që të kenë edhe përfaqësuesit e tyre në këtë gjykatë.

Po ashtu, tjetra nuk pajtohem që ka shuarje të të gjitha strukturave paralele, kjo nuk është e vërtetë. Ndërsa, sa i përket pyetjes për zonjën Hoxha kush do të mund t'i shkarkojë këta prokurorë dhe gjykatës, kush e ka atë kompetencë? A keni ju apo e ka veriu atje? Dhe kur pritet që këta gjyqtarë ta bëjnë betimin? Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zonja Bajrami! Zoti Zemaj, në rregull Danush Ademi.

DANUSH ADEMI: Faleminderit, kryesuese!

Përsëritje për ministren Edita Tahiri mua më intereson fakti se shumë bisedime vazhdimisht janë shtruar në Bruksel dhe vazhdimisht për çdo temë është biseduar vetëm për komunitetin serbë. Asnjëherë nuk kemi dëgjuar që në ato tryeza ka qenë pikë e rendit të ditës komunitetet tjera që i diskutuan edhe kolegët, për çfarë arsye

a nuk njihen komunitetet në Kosovë edhe këto komunitete tjera që jetojnë në Kosovë, apo vetëm është interesant aq shumë vetëm komuniteti serbë që është pikë e rendit të ditës vetëm në Bruksel.

Asnjëherë deri më tani për tri mandate për sa jam deputet nuk e kam dëgjuar që është bërë një pikë të ngritet për komunitetet tjera, sepse edhe këta komunitete tjera i kanë problemet ndoshta jo të barabarta me komunitetin serbë, por kanë në cilësi tjera. Mua më intereson për çfarë arsye nuk bisedohet si temë asnjëherë dhe nuk e llogarit si komunitete edhe ata janë pjesë e Kosovës, po foli për komunitetin ashkalinj, romë, egjiptas, turk, boshnjak, goranë, asnjëherë nuk po dëgjojmë. Çka është problemi me këto komunitetet tjera?

Ato, zonja ministre tha që 9 persona do të pranohen në Këshillin Gjyqësor mu duk tha asnjë s'u përmendi komunitetet tjera, por edhe integrimi i këtyre komuniteteve dhe një pako të problemeve që e kanë çka do të ndodh, çfarë po ndodh me këto komunitetet tjera, a keni mundësi të paktën sa takime i keni pasur në Bruksel deri më tani, dhe a ka qenë njëherë pikë e rendit të ditës për komunitetet tjera?

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Ademi! Armend Zemaj e keni fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, nënkryetare!

Të nderuar kolegë deputetë,

Ministre të nderuara,

Gjithë përfaqësuesit, pak a shumë jemi të vonuar në trajtimin e kësaj çështjes si Komision për Legjislacion arsyet janë të dyanshme, por ndoshta jemi në ... më të duhur që kemi ardhur te implementimi i marrëveshjeve dhe sigurisht që edhe mund t'i trajtojmë qoftë përparësitë, qoftë defektet që kanë vetë marrëveshja për drejtësinë nga baza fillestare, nga nënshkrimi i parimeve bazë të marrëveshjeve ku ka hy edhe drejtësia në pikat e përgjithësuara edhe e cila është zbërthyer edhe nga grupi punues, nga marrëveshja shtesë për drejtësinë.

Besoj që edhe zonja Edita Tahiri nga fjala e vetë pak a shumë edhe në nuancën e përgjithshme jo pse duhet të jemi skeptik në gjithçka çka është rreth dialogut mbi të gjitha sidomos për transparencën sepse është njëra ndër marrëveshjet e pakta që nuk është në ueb faqen që t'i adresohet edhe publikut edhe neve si deputetë. Dhe sigurisht që kjo qoftë në aspektin politik edhe atë profesional, atëherë krijon zbrazëti dhe të interpretimit të saj. Vetë marrëveshja në fjalë besoj që ka disa nuanca, të cilat e prekin ligjshmërinë dhe kushtutshmërinë në vend edhe kjo nuk do fjalë dhe nuk do koment, sepse derisa ne e kemi një ligj në fuqi për gjykatat e kemi edhe ndarjen administrative të gjykatave edhe themelore, por mbi të gjitha

ajo çka është më problematike dhe më sensitive Gjykata e Apelit tregon qartë që këtu ka disa ta quaj dyshime tash edhe rreth implementimit të saj, zbatimi i kësaj marrëveshje në përgjithësi.

Nuancat e krijimit të gjykatave mono-etnike shihen qartë dhe kjo nuk e di se si do të përfundojë në tërësi duke marrë parasysh sidomos qoftë edhe integrimin e strukturave paralele që ju i përmendët, sepse brenda marrëveshjes flitet për to ndërsa pjesa tjetër që u adresua ministrja e Drejtësisë flet për një proces të rregullt të rekrutimit i cili domethënë nuk është i rregullt është devijim nga ajo pjesa kryesore që është e ligjit edhe kriterëve të barazisë para ligjit në përzgjedhjen edhe rekrutimin e gjyqtarëve në këto dy nivele.

Tash pse po them, sepse ndarja territoriale sipas nenit 9 të gjykatës themelore e përcakton gjykatën themelore të Mitrovicës si një njësi duke nënkuptuar edhe katër komunat tjera që janë në pjesën veriore të Mitrovicës. Ndërsa, apostrofimi apo shkrimi edhe në vetë marrëveshjen që duke shkruar edhe godinat se ku do të vendosen kjo tregon qartë që në atë që ne e quajmë integrim do të jetë integrim etnik dhe shumica shqiptare apo ligji do të jetë pak vështirë i implementuar dhe në praktikë.

Kjo është edhe shqetësimi ynë, sigurisht ju e keni debatuar edhe e keni një shpjegim shtesë për këtë ne mund këtu edhe ta debatojmë edhe ajo çka është më sensitive dhe më e ndjeshme është Divizioni i Apelit. Në nenin 17 të Ligjit për gjykatat dhe Gjykata e Apelit, selinë qendrore e ka në Prishtinë sipas këtij ligji dhe normal kuptohet sipas kompetencës e ka gjykon në shkallë të dytë, me juridiksion në të gjithë territorin e Republikës së Kosovës. Krijimi i divizionit dhe bartja e lëndëve nga komunat me shumicë të popullatës serbe krijimi i ta quaj edhe i paneleve me shumicë të pjesëtarëve etnik serbë, domethënë është etnike. Pavarësisht që thotë që edhe dy nga 7 anëtarët janë 2 shqiptar.

Dhe tash kjo do të jetë pak problematike unë e kam parë edhe rregulloren të cilën e kanë nxjerr Këshilli Gjyqësor, bartjen e lëndëve, që duhet të jetë nga gjykatat themelore me kërkesë të kryetarëve të gjykatave dhe kjo besoj që edhe me at pjesën tjetër që lidhet edhe me rekrutimin mendoj që pak a shumë do të kemi vazhdim të kësaj problematike edhe gjithmonë po e them ka barazi para ligjit, me një tendencë që mund të kemi edhe amnistim të njerëzve, por edhe gjykim jo të drejtë duke marrë parasysh në pjesën ku e kryen veprën edhe në cilin territor një anëtarë i komunitetit serbë e kryen veprën në territorin e Republikës së Kosovës, ndërsa në shkallë të dytë nga këto komuna duhet të dërgohet në divizionin e apelit në pjesën veriore.

Domethënë, këto janë disa çështje nuk janë të zbërthyera në marrëveshjen e vitit 2015, janë në pjesë të përgjithshme edhe pse pika 5 për shembull domethënë e tregon shumica e rasteve që vijnë nga komunat ku ndodhen degët do të gjykohen në ato degë në përputhje me ligjin dhe pika 6, në Kosovë kryetari i Gjykatës Themelore është ai që i cakton vetë gjykimet, këtu po flas për gjykatat themelore.

Dhe, te pjesa që e potencoi ministrja e Drejtësisë te rekrutimi. E përmendi provimin e jurisprudencës si të përgjithshme dhe këtu po bëhet fjalë për integrim të gjyqtarëve dhe prokurorëve që kanë punuar nën juridiksionin paralel të shtetit serbë. Dhe tash është pjesa e kualifikimit për gjyqtarë. Sipas ligjeve të Kosovës dhe Ligjit për gjykata kërkohet përvoja e punës, tash përvoja e punës a do të jetë bazike me ligjet e Kosovës apo do të bartet nga mandati që kanë ushtruar nën juridiksionin paralel serbë, sidomos prapë po e potencoj për kualifikimet që janë për gjyqtarë në Gjykatën e Apelit duke marrë parasysh që kërkohet një përvojë e konsiderueshme dhjetë vjeçare të ushtruarit përvojë pune në pjesën juridike, dhe 3 vjet si gjyqtar.

Domethënë këto janë disa shqetësime tona që unë besoj që duhet t'i adresojmë, mbi të gjitha vetë shtyrja e implementimit të kësaj marrëveshjes, më 10 janar, .. e dëgjuam që është më 17 janar, sot jemi me datën 22 shkurt, arsyetimet i dëgjuam për mua nuk është si deputet sepse këto flasin për një marrëveshje të vitit 2015, domethënë e stërzgatur grupin punues në vitin 2016, tash jemi në vitin 2017 dhe askush nuk e dinë se çka po ndodh në sistemin juridik në pjesën veriore të Kosovës. Domethënë, kush po gjykon, si po gjykohen, si po trajtohen, a po pranohen lëndët, sepse në marrëveshjen e 2015-ës tash mu kujtua një prej pikave thotë “ nuk do të pranohen lëndë të reja derisa të hynë në implementim” dhe besoj që këto sigurisht edhe nuk dua tash të paragjykoj por këto duhet të jenë shqetësim edhe për vetë juve sepse jeni më afër, i përcillni edhe qoftë edhe për Ministrinë e Drejtësisë, mbi të gjitha edhe neve si deputetë dhe njerëzit që marrin edhe opinione edhe përgjegjësi tjera, shqetësime të qytetarëve të vendit.

Unë po besoj në qëllimin e mirë që ka pas domethënë integrimi i këtyre strukturave por duhet të jemi të vëmendshëm, sepse po duket që ndonjëherë kjo është shtylla kryesore për mua e shtetit edhe funksionimit të rendit dhe ligjit në vend qoftë edhe unë nuk e ndaj, sepse vetë shqetësimi im është në nuancat etnike pavarësisht, sepse drejtësia duhet të vlejë për të gjithë dhe sistemi i drejtësisë duhet të jetë unitar ashtu e kemi të përcaktuar edhe me Kushtetutë, ashtu janë edhe të zbërthyera me dy ligjet.

Ministrja e Drejtësisë e potencoi që ne tash jemi në plotësim ndryshim të ligjeve edhe nga monitorimi që e ka bërë Komisioni për Legjislacion, nëse ju ka referuar pjesës të harmonizimit tash të këtyre çështjeve që janë shqetësuese edhe pjesë të marrëveshjes është diçka që duhet të thuhet, sepse sigurisht që ajo do të vjen në Kuvend edhe të harmonizohet edhe me Ligjin për gjykatat dhe Ligjin për këshillin gjyqësor dhe Këshillin prokurorial.

Unë pavarësisht nuancave që u është dhënë që të thirremi në Ligjin për gjykata, domethënë qoftë edhe të krijimi të divizionit sepse aty thuhet krijohen divizione por aty është fjala për departamente sepse mua më kujtohet fort mirë zonja ministre kam qenë në vitin 2010 kur është punuar në Ligjin për gjykatat dhe lufta kryesore politike është bërë për Gjykatën e Apelit që të jetë një gjykatë e apelit në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Domethënë në atë kohë ishte ministrja e ndjerë zonja Nekibe Kelmendi. E kam udhëheq këtë grup punues në kuadër të Kuvendit të Kosovës dhe e ka një histori të vetë, përkundër presionit qoftë edhe vendor qoftë edhe ndërkombëtar domethënë kjo është vendosmëria që e ka pas Kuvendi i Kosovës që sistemi të jetë unitar sidomos në sistemin e drejtësisë në vend.

Dhe ju duhet të na garantoni neve sot kuptimin sepse jo të na garantoni sepse nuk duhet t'i paragjykojmë zhvillimet dhe nuk varet vetëm nga një dikaster, qoftë edhe nga tash implementuesja ministrja e Drejtësisë se varet këtu nga shumë faktorë tjerë, por duhet të na garantoni neve si komision, si anëtarë të këtij Kuvendi, por mbi të gjitha si përfaqësues të qytetarëve të vendit se këto marrëveshje nuk ... nga ligjet dhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës, se si do të implementohen do të jemi përgjegjës të gjithë, do ta përcjellim edhe implementimin qoftë edhe ndikimin çfarëdo që ka ato.

Për këto pika që unë i potencova, sepse janë fol shumë edhe në publik ju e dini, ju është dhënë edhe ngjyrë politike sigurisht se kanë të drejtë edhe njerëzit edhe nga aspekti jo profesional, por sido që të jetë mendimi im është që ne duhet të jemi shumë të vëmendshëm sepse nuk do të ketë kthim mbrapa. Nëse tash sanksionohen këto me ligj krijohet një sistem që mund të jetë ta quaj "paralel" por me ligje të Kosovës besoj që nuk do të na ndihmojë as në integrimin tonë, as në kërkesën që rendi dhe ligji të funksionojë në tërë territorin e Republikës së Kosovës. Faleminderit!

SELVIJE HALIMI : Faleminderit, Armend! Doruntina!

MINISTRJA EDITA TAHIRI : Po, e di që e kemi gjithmonë... po, unë me vëmendje i dëgjoj, po po më duket po mbeten shumë pyetje pa u përgjigj për shkak

se po ndodhin shumë pyetje dhe nga përvoja e komisioneve tjera e kam vërejt që s'po munden, po e citoj me u... nëse doni pjesë pjesë, ju e dini veç deshta me ju tregu që më ka ndodhë, po jo, jo, mos e prishni ju rendin, ju lutem. Urdhëroni!

SELVIJE HALIMI: Don me bo pyetje, Nezir!

NEZIR ÇOÇAJ: Unë i kam dy pyetje shumë të shkurta.

SELVIJE HALIMI: Ani, zoti Çoçaj,

MINISTRJA EDITA TAHIRI : Jo, jo, edhe Doruntina. Në rregull, veç i tregova një përvojë që... se po bohen shumë.

SELVIJE HALIMI: Zonja Maloku.

DORUNTINË MALOKU: Faleminderit!

Përshëndetje për të gjithë!

Përshëndetje për ministren Tahiri, ministren Hoxha!

Unë kam disa pyetje të shkurta.

Çfarë do të ndodhë me masat disiplinore mbi gjykatësit dhe prokurorët serbë? A do të zhvillohen këto nga zyra e prokurorit disiplinor? Çfarë do të ndodhë me sistemin përmbarues dhe sistemin e noterisë? A do të shtyhet ajo edhe në veri?

Edhe një pyetje tjetër: Sa janë informuar qytetarët serbë në veri të Kosovës, për marrëveshjen e drejtësisë dhe a do të jenë ata të gatshëm, që tash e tutje të gjykohen me ligjet e Kosovës? Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Zoti Çoçaj.

NEZIR ÇOÇAJ: Faleminderit, kryesuese!

Faleminderit, zonja ministre, dy ministre në fakt, faleminderit! Unë për të mos e zgjatur, i kam dy pyetje të shkurta dhe të vogla.

Pyetja e parë ka të bëjë me ministren Tahiri, e cila potencoi shumë mirë, që ka bërë pala jonë, pra Qeveria e Republikës së Kosovës në raport me marrëveshjen. Po më intereson se cilat janë ato obligime të cilave nuk i është përmbajtur apo nuk i ka përmbushur Qeveria e Serbisë?

Çka parashihet në bazë të marrëveshjes dhe si e ka paraparë ... përmbush.

Për ministren e drejtësisë: E nderuar, po ashtu edhe ju i përmendët të gjitha këto. Po më intereson çështja për komunitetin serb të gjyqtarët dhe prokurorët që kanë hyrë në provim të jurisprudencës, po më intereson numri sa kanë hyrë, e potencuat sa por po më intereson edhe përqindja. A nënkupton ajo që të gjithë ata që kanë hyrë e kanë kaluar provimin e jurisprudencës, gjegjësisht me statistika a kanë qenë më të mirë se prokurorët dhe gjyqtarët shqiptarë apo jo. po dua ta mas njëfarë sistemi të krahasimit, kështu... nëse mundet. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Si ta përfundojë Agim Ademi, pastaj ju Valdete. Zoti Agim Ademi.

AGIM ADEMIJ: Faleminderit, nënkryetare!

Përshëndetje për të gjithë!

Ministre,

Zonja Tahiri, a bën ta di cilën ministri udhëhiqni ju? Si quhet ajo ministri dhe Neziri e shtroi këtu, cilat obligime s'i ka përmbushur Serbia e unë po e shtoj a ka diçka në marrëveshje, që ne nuk i kemi përmbushur. E kam fjalën për marrëveshjen e drejtësisë, kuptohet.

MINISTRJA EDITA TAHIRI: Që doni, ju përgjigjem edhe të tjerave, ...

AGIM ADEMIJ: Po, pra! Objektet ku do të vendoset Gjykata dhe Prokuroria. Ju e thatë, se është jashtë kompetencave tuaja të ministrisë, a është punuar, a ka diçka në ato objekte? I kam dëgjuar gjyqtarët që thonë se është punuar diçka, janë caktuar afatet. U përmend këtu, nuk janë respektuar ato afate, janë përzgjedhur gjyqtarët, a kanë dhënë betimin para presidentit?...

Janë çështje ndoshta teknike, por janë shumë të ndjeshme dhe çështje që avancojnë procesin.

Domethënë, përafërsisht këto janë. Armendi e shtroi mirë, nëse kemi një sistem unik të drejtësisë, po nënkuptohet që do të veprojnë me ligje të Kosovës, po marrëveshje duhet të kemi kujdes, se janë specifika që mund të na çojnë në dualizëm, në probleme që do të lindin më vonë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit, zoti Ademaj! Valdete Bajrami dëshiron ta korrigjojë pyetjen.

VALDETE BAJRAMI: Shkurt! Zonja Tahiri, aty kur mendova që po ata persona do të punojnë kundër shqiptarëve, e kisha fjalën kundër interesit shtetëror. Kështu që, vetëm ta kemi të qartë. Faleminderit!

MINISTRJA EDITA TAHIRI: E kuptova, pa shqetësime. Këtu jemi edhe për t'u shpjeguar lidhur me... pa keqkuptime.

KRYESUESJA: Zonja ministre, fjala për ju.

MINISTRJA EDITA TAHIRI: Megjithëse Nezirin e kam vendës atje, pyetjet e deputetit Zemaj për mua ishin më qenësore në kuptimin e ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë. Nëse pajtoheni, do të filloj me të e pastaj edhe me pyetjet tjera.

E para, marrëveshja për drejtësi buron nga marrëveshja për normalizimin e marrëdhënieve në mes dy shteteve të vitit 2013 dhe që është ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës me Ligjin për ratifikimin dhe nuk besoj që Kuvendi i Kosovës do të miratonte një marrëveshje që do të ishte në kundërshtim me ligjet dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

E dyta, unë kam thënë në vazhdimësi dhe do ta përsëris, të gjitha marrëveshjet në Bruksel janë arritur në pajtim me ligjet e Kosovës dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës. I kam thënë gjithë opinionit, analistëve, gazetarëve po edhe deputetëve, urdhëroni studioni, nëse gjeni ndonjë marrëveshje që cenon ligjet e Kosovës, pra unë vazhdimisht po vij në dëgjimet publike, dëshiroj të ballafaqohem.

Me këtë thirrje jam prej fillimit të 2011-ës, askush nuk ka ardhur të më thotë apo publikisht të më thotë, “kjo marrëveshje, kjo pikë, është në kundërshtim me ligjet e Kosovës”.

E dyta, marrëveshja për drejtësi përcakton që Gjykata themelore në regjionin e Mitrovicës do të rivendoset, pra ka ekzistuar po do të rivendoset, sipas ligjeve të Republikës së Kosovës dhe sipas ligjeve të Republikës së Kosovës Gjykata Themelore në Mitrovicë mbulon shtatë komuna dhe ato janë: Vushtrria, Skenderaj, Mitrovica e Jugut, Mitrovica e Veriut, Zveçani, Leposaviqi dhe Zubin Potoku. Pra, nuk është e vërtetë që Gjykata Themelore e Mitrovicës do të veprojë në vetëm katër komuna, siç e dëgjova.

E njëjta vlen edhe për zyrën e prokurorisë për regjionin e Mitrovicës, vepron për këto shtatë komuna, ashtu siç e thotë ligji përkatës i Republikës së Kosovës.

Dëshiroj pra, të jetë kjo e qartë dhe dëshiroj që në momentin kur të fillojë zbatimi, ndoshta bashkë me ju, ta bëjmë një vizitë monitoruese në këtë gjykatë dhe në këtë zyrë prokurorie, bashkë ta bëjmë dhe pas asaj, përsëri të debatojmë. Pra, unë ju garantova, meqë kërkuat garanci dhe pastaj bashkë do ta monitorojmë.

Tutje, kjo gjykatë themelore dhe kjo zyrë prokurorie në asnjë rast nuk është monoetnike, unë vetëm sa e përmenda që stafi gjyqësor, që momentalisht është në Vushtrri e që vepron në Gjykatën Themelore, do të bartet në Mitrovicë, po ata janë krejt shqiptarë dhe atyre do t'u bashkohen edhe ata që janë rekrutuar nga komuniteti serb.

Mos e ngatërroini, nuk kemi integruar struktura vetëm individë, strukturat i kemi shuar që nga shtatori i vitit 2013 dhe ku janë ato lëndë? Të deponuara te EULEX-i në mënyrë që pastaj prej aty të barten përsëri në gjykatë për t'u trajtuar.

Tjetër, si do të jetë bilanci etnik? Do të jetë në bazë të ligjeve të Republikës së Kosovës dhe ligjeve afirmative, që i kemi në raport me stimulimin e integritetit të minoriteteve dhe që në këtë rast, sidomos kjo pjesë e minoritetit serb, që është manipuluar nga Serbia, ky ligj afirmativ vlen edhe më shumë se kaq.

Dëgjova pyetjen, pse nuk flitet për minoritetet tjera në Bruksel? Unë e thash në fillim dhe dëshiroj ta përsëris, Kosova jo vetëm na Rajon, në Botë është model se sa u ka dhënë të drejta minoriteteve, dhe atë jo me fjalë, por me Kushtetutë dhe me ligje. Edhe të gjitha minoritetet, përveç minoritetit serb, kanë qenë bashkë me shqiptarët, me shumicën shqiptare, për ta bërë pavarësinë. Dhe, nëse ne kemi qenë bashkë, kemi çliruar bashkë Kosovën, e kemi bërë shtet të pavarur, në qoftë se ne bashkëpunojmë rregullisht, çfarë nevojë ka që të bisedohet në Bruksel? Në Bruksel mund të bisedohet veç nëse kemi probleme! Por, sa e di unë, probleme s'kemi, por ne kemi angazhim maksimal. E di, që nuk janë plotësuar të gjitha kërkesat, por në asnjë shtet nuk mund të plotësohen krejt, për një periudhë sa vjet i kemi, 9 vjet.

Hajde dalim te shqiptarët e Maqedonisë, që fare nuk janë minoritet, janë baras me maqedonë... a e dini sa larg është zbatimi i marrëveshjes së Ohrit, që duhet Maqedonia ta respektojë në raport me shqiptarët. Nuk po dua të bëj krahasime më shumë, me dalë te Lugina e Preshevës, ku shqiptarët atje vazhdojnë të jenë të diskriminuar në mënyrë shumë brutale, ndoshta nuk ka dhunë fizike, veç fakti që Serbia ua ka humbur perspektivën shqiptarëve atje, as të drejta për shkollim të lartë universitar, në mënyrë që të mos krijojnë mësimdhënës për të përgatitur gjeneratat e reja, as perspektivë për punësim. Prandaj, u befasova me pyetjen.

Në Bruksel shkohet kur ka probleme, unë besoj se ne i kemi mirë, ju jeni integruar, por ne si Qeveri premtojmë përkushtim edhe më shumë që të mbështesim edhe komunitetin ashkali edhe të gjithë të tjerët.

Pra, çështja është se Serbia ka ndërhyrë në Kosovë me struktura paralele dhe çështja është se Serbia i ka penguar Serbët, sidomos të veriut, me u integrua në institucionet e Kosovës, pra ata janë... ata nuk janë problemi, serbët e Kosovës nuk janë problemi, janë bërë problem se i ka manipuluar Serbia dhe dialogu i Brukselit po ndihmon, që Serbia të ndalë ndërhyrjen, të mos i pengojë serbët e Kosovës që të integrohen, pjesa më e madhe janë integruar, vetëm këta të veriut kanë qenë peng. Pse kanë qenë peng, të gjithë e dinë, sepse pasuria kryesore e Kosovës ka qenë dhe është në veri, është në Mitrovicë, pra nuk është veç veriu. Kryesorja, ajo zonë është atraktive për mendjet koloniale dhe burimet e ujit, janë strategjike edhe minierat edhe uji.

Kjo ka qenë pra... ato iluzionet, prandaj Serbia ka vazhduar ndërhyrjet, por ky dialog i Brukselit po e nxjerr Serbinë nga veriu. A ka ende? Ka ende struktura, kurrë s'kam thënë që të gjitha janë shuar, por shumica janë shuar e çfarë do të ndodhë me të tjerat, se e kishit ju pyetje. Ne kemi bërë kushtëzim të qartë. Nuk ka themelim të asociacionit të komunave me shumicë serbe pa u shuar të gjitha strukturat e mbetura paralele në Kosovë. ndërsa, sa jam te asociacioni, edhe një herë dëshiroj të ju them, asociacioni duhet të jetë në pajtim me ligjet e Kosovës, vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës me marrëveshjen e Brukselit dhe nuk do të ketë kompetenca ekzekutive, as nuk do të jetë një nivel i tretë i qeverisjes në Kosovë, sepse Kosova është shtet unitar. Pra, edhe në sistem të drejtësisë është ruajtur unitariteti.

Të kthehem, si është ruajtur unitariteti, sepse marrëveshja për drejtësi nuk kërkon ndryshime ligjore për ta zbatuar. Paramendoni, po të arrinim një marrëveshje, që pastaj duhet të vinim në Kuvend të kërkonim ndryshime ligjore, aty do të prekej unitariteti i drejtësisë. po, marrëveshja nuk kërkon ndryshim ligjor, përkundrazi respekton ligjet.

E përmendët divizionin e apelit dhe u përmend a jemi të sigurt që këta serbë do të punojnë lojalisht në raport me shtetin e Kosovës. shikoni, Kosova nuk është as vendi i parë as i fundit, që ka pasur probleme, që një pjesë e një komuniteti pas luftës nuk dëshiron të integrohet apo është i udhëzuar negativisht që të mos integrohet.

Ne kemi rastin e Kroacisë, e cila pas përfundimit të luftës ka pasur probleme në Sllavoninë Lindore, ku Serbia përsëri, ka udhëzuar serbët e asaj pjese të Kroacisë të mos integrohen në sistemin shtetëror të Kroacisë. Mirëpo, tash Kroacia nuk ka vepruar në kuptimin e dyshimeve, a t'i marrë këta njerëz se ndoshta nuk punojnë kundër nesh, por përkundrazi, sikur edhe çdo shtet, ani që një pjesë e komunitetit t'u ka manipuluar, shteti e ka obligim të krijojë masat për t'i rikthyer njerëzit në sistem. Ndoshta, ditët e para mund të ketë dilema, por në një kohë ata e kuptojnë realitetin edhe e pranojnë.

Unë jam në kontakte përmes tryezave të ndryshme drejtpërdrejtë me serbët e pjesës veriore. Ka dy-tri vjet që unë gati çdo muaj nga një ditë e shpenzoj në tryeza që organizojnë organizatat joqeveritare, për të biseduar me ta.

Po më ndërhyjnë zonjë, po më ndërhyjnë. A ta përfundoj, se edhe ... a ta përfundoj?

Po ju them, prej kohës kur kanë filluar bisedat direkte dhe këto ditë unë ju ftoj edhe juve të vini në ato tryeza. Ata kanë ndryshuar shumë mendësinë e tyre. Ka raste, kur hapur flasin, që kanë qenë të manipuluar dhe janë duke kuptuar realitetin dhe thonë, se kanë nevojë edhe ata për një jetë normale dhe jo jetë të manipuluar e jetë paralele. Kur të doni aty ku më ftojnë mua, do t'ua bëj ftesën dhe ju lutem, bashkëngjitu.

Pra, Kroacia kështu ka bërë. I ka integruar dhe pastaj kanë vazhduar proceset e masave të mirëbesimit. Kur i pranuan policët, çka kemi bërë? I kemi bërë pjesë të trajnimeve, jo vetëm profesionale, por trajnime të reintegrimit për t'i bërë ata të kuptojnë çka është kalimi prej një realiteti në tjetrin. unë e përmenda Kroacinë, por në Botë ka shumë raste, kur ka ndodhur kështu, një pjesë e një grupi nuk dëshiron të integrohen, por në proceset që po i bëjmë ne i kanë bërë edhe të tjerët. situata ka ndryshuar, problemet janë zgjidhur.

Tani vazhdoj tutje, përbërja etnike, edhe një herë, do të jetë inkluzive, do të ketë elementin afirmativ, por kurrësi monoetnike. Do të jetë, pra, një përbërje që nuk bie ndesh me ligjet e Kosovës për minoritete, por as natyrisht, nuk cenon shumicën shqiptare, se... ky vend është i shumicës shqiptare dhe i minoriteteve, mirëpo ne e dimë që sipas komunave do reflektojmë edhe të pasqyrës etnike.

Përndryshe, nuk e thash në fillim, por do të ketë edhe katër degë të gjykatës themelore në Mitrovicë, pra do të jetë dega në Vushtrri, Skenderaj, Zubin Potok dhe Leposaviq. Pastaj, tutje të shkojmë, transparenca. Zonja Bajrami, keni të drejtë, transparenca në dialog nuk ka qenë e nivelit siç është pritur nga Kuvendi

ose nga opinionioni publik. mirëpo, negociatat zakonisht e kanë një rrjedhë të tillë, që është e pamundur që të jetë transparenca 100%. Pse? Sepse, procesi negociator ndryshon prej raundit në raund. Dhe, ne nuk mund të japim çfarë po ndodhë, se atëherë kur vjen rezultati i fundit, një lexues ka mundur të lexojë atë çfarë ka ndodhur në negociata dhe s'e ka lexuar fundin.

Ajo, çfarë unë gjithmonë kam bërë, është që t'i publikojmë marrëveshjet në ueb-sajtin e Qeverisë edhe me vend është vërejtja për marrëveshjen për drejtësinë. Në momentin kur ndodh dekretimi dhe rihapja e këtyre gjykatave dhe bartja e gjykatës nga Vushtrria edhe marrëveshja do të jetë publike, se i kemi deri tash mbi 35 marrëveshje, të gjitha janë edhe kjo do të jetë.

Tani, shkojmë tutje, si do të jetë betimi? E kemi ministren këtu, por do të jetë sipas ligjeve të Republikës së Kosovës. presidenti do t'i dekretojë, do të japin betimin.

Pse po vonohet, ishte pyetja? Sa obligime s'i ka kryer Serbia? Shikoni, kjo marrëveshje, e thanë disa deputetë, gati katër vjet ende s'është zbatuar.

Kjo tregon edhe një herë më shumë, që Serbia me dëshirë nuk i bën këto marrëveshje. Ju e dini kodi telefonik gjashtë vjet është vonuar, energjia është ende e bllokuar, por shumë marrëveshje tjera janë zbatuar.

Pse i vonon Serbia? Sepse, Serbia duhet të tërheq strukturat paralele për të mundur të zbatojë marrëveshjen, derisa Serbia i ka bindur këta serbë në Kosovë që "ju do të jeni në institucionet e Serbisë", tani duhet ta ndryshojë. Pra, vonesa vjen sepse i nënshkruan marrëveshjet, se kërkon që të përparojë drejt Bashkimit Evropian, në anën tjetër po të ketë mundësi mos t'i zbatojë. Mirëpo, Bashkimi Evropian nuk lejon përparim drejt Bashkimit Evropian pa zbatim të marrëveshjes. Kjo nuk është vetëm për Serbinë, kjo është edhe për ne. ju e dini sa presionet i kemi tash për asociacionin. Pra, në të gjitha të tjerat ne kemi qenë efektivë, kemi zbatuar marrëveshjet. Një marrëveshje që e kemi vonuar, është marrëveshja për kadastrat, ju e dini fort mirë pse është vonuar, sepse Kuvendi i Kosovës katër vjet nuk e ka miratuar ligjin, tash jemi në proces të zbatimit. Por, Serbia ka vonuar një varg marrëveshjesh, po them, marrëveshja për diploma është e njohur që vonohet ende. Energjia, ua thash, edhe kjo gati katër vjet.

Pra, ky është standardi i dyfishtë i Serbisë, nëse mundet veç me i nënshkrua, por mos me i zbatua. Fakti që Bashkimi Evropian është ndërmjetësues dhe fakti që Bashkimi Evropian e ka kushtëzuar dialogun e Brukselit me përparimin e shteteve drejt Bashkimit Evropian është një kusht i qartë, fundi i fundit, besoj se e keni

parasysh që dialogu i Brukselit ka dhënë kontribut të drejtpërdrejtë për marrjen e marrëveshjes së stabilizim asocimit për Kosovën, sepse ne vazhdimisht kemi zbatuar obligimet e dialogut të Brukselit.

Tani të shohim tutje, unë u ankova për shumë pyetje, por sa po shoh, jam kah i përfundoj.

Po, masat disiplinore, besoj, ministren e kemi këtu për pyetjen e Doruntinës. Natyrisht, që edhe sistemi përmbarues dhe i noterisë në fazat e ardhshme duhet të jenë prezente, të kompletojmë sistemin unitar të drejtësisë së konsoliduar edhe në pjesën veriore të vendit. Sa presim a do t'i respektojnë qytetarët institucionet e drejtësisë.

Lëndët e tyre janë të ngrira në pritje. Natyrisht, secili është i interesuar për t'i zgjidhur, do t'i respektojë, në anën tjetër, siç e thash, po ndryshon mentaliteti për serbët e veriut, janë në kërkim të një jete normale dhe po e kuptojnë që manipulimet politike e nacionaliste të Serbisë po i dëmton ata. Vetëm një, një segment, një moment po ua them, kur bëme integrimin apo punësimin e këtyre ish-pjesëtarëve të mbrojtjes civile, pra e shuam mbrojtjen civile edhe i punësuam ata. Kisha unë në këto tryeza nënën e njërit prej tyre që ishte punësuar tashmë në institucionet e Kosovës, këtë ma tha. “kam qenë gjithmonë e brengosur, që djali im punonte në një strukturë të tillë, prej ditës që ka filluar punën në institucionet e Kosovës, jo vetëm unë, e gjithë familja jemi qetësuar.” Pra, vetëm një moment të një deklarimi të sinqertë për atë se çfarë po ndodhë. Nuk po them, se janë kryer punët, do të kemi shumë punë, por trendi është pozitiv.

Obligimet e papërmbushura të Serbisë. Shikoni, e para është mungesa e vullnetit politik, se kur ka vullnet politik, siç është dëshmuar në zbatimin e marrëveshjeve tjera, atëherë kanë ecur, Kosova mori në dhjetor kodin telefonik shtetëror, sepse ishte edhe vullneti politik i Serbisë, që të zbatojë obligimet nga marrëveshja. Tani ne jemi në fazën e fundit. Ne kemi dekretimin, vendosjen e institucioneve dhe konkursin për kryetarin e Gjykatës Themelore dhe Zyrës së Prokurorisë. Në ditën që do të ndodhë dekretimi, atë ditë, para dekretimit Serbia duhet të prezantojë në Bruksel dhe Brukseli tek ne vendimin për daljen e pagave dhe shfuqizimin e kontratave të punës me këta njerëz.

Pa atë vendim ligjor, as ne s'mund të marrim gjykatës që nuk e kanë të definuar këtë çështje.

Nëse kam lënë diçka, prapë do të përgjigjem më vonë. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit shumë zonja ministre! Zoti Zemaj ka një pyetje shtesë.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit ministre për përgjigjet!

Kur të mendojmë për transparencën, po flas personalisht, nuk mendoj për atë transparencën që ju gjatë bisedimeve të lidheni me video-link dhe me pa ne çka po bisedoni, por së paku marrëveshjet të publikohen, dhe kjo është ndër marrëveshjet, të them prapë, më të rëndësishme apo njëra më të rëndësishmet që kërkon vështirësi në implementim.

Unë, edhe pse i përmenda ato nuancat mono-etnike. Prapë po t'i përsëris sepse edhe kjo lidhet me transparencë, sepse nuk është kurrëgjë e keqe të na thuhet edhe neve dhe qytetarëve të vendit – këtë është dashur ta negociojmë, është në harmoni me ligjin, por nuk e thotë ligji. Për shembull, zgjedhja e kryetarit të gjykatës. Në cilin ligj thuhet që kryetari i gjykatës duhet të jetë serb?

Do të thotë, kjo është një prej atyre që është pjesë e shkruar në marrëveshje, dhe nuk është keq me thënë – po deputetë, ne është dashur ta bëjmë një kompromis, të dhimbshëm, sipas ligjit, sepse njerëzit duhet të konkurrojnë që të zgjidhen për kryetarë të gjykatave atje.

E dyta, është dashur që ne të themi se shqiptari do të jetë kryetar i Prokurorisë Themelore, ndërsa serbi të jetë kryetar i gjykatës, sepse është në marrëveshje, dhe atë që unë e përmenda – ndarja në degë, është pjesë e marrëveshjes.

Pra, nëse është kjo që ne e kemi tash, sepse burimin e kemi...

(Ndërhyrje)

Jo, s'ka lidhje. Këto janë dy çështje që lidhen edhe me transparencën, që unë i potencova.

Dhe, prapë po them edhe te implementimi, dhe mos ta teprojmë me këtë fjalën mono-etnik, te divizioni i apelit.

Shtojca 3. Komunitat me shumicë të popullatës serbe janë të renditura të cilat kanë të drejtë të delegojnë lëndë në Gjykatën e Apelit, do të thotë ekskluzivisht. Por çka, nëse një serb nga Prishtina do ta çojë në shkallë të dytë të Gjykatës së Apelit në pjesën veriore.

Do të thotë janë disa pyetje që unë besoj se ministrja e Drejtësisë, Këshilli Gjyqësor, Këshilli Prokurorial do të përballlet me to në implementim në praktikë. Do të thotë nuk janë diçka që janë temë tabu, sepse janë qartë edhe të shkruara, e tash nuk e di, mund ta keni edhe ju këtë, e ne e kemi dhe thashë që s'është zyrtare, por është marrëveshje, po është edhe Rregullorja që e ka miratuar Këshilli Gjyqësor për organizimin e brendshëm të gjykatave, që i nënshtrohet marrëveshjes së vitit 2015, këtë që e kemi këtu në vija të trasha.

Pra, këto janë ato elementet që unë i potencova. Sigurisht, nesër po të jemi në pozicion, do të thotë, duhet të përballesh me implementim, pavarësisht qëllimit të mirë dhe ata shembujt e mirë që ju i dhatë, ose edhe këto defektet që ne e dimë me kë kemi punë, e dimë se në dialog nuk është shkuar për dëshirë, sepse po të ishte gjithçka në rregull edhe s'kishte pasur nevojë që ne të shkojmë atje, e as të bisedojmë, por ligji do të kishte vleftë për të gjithë në mënyrë të barabartë.

Pra është kjo pa ndonjë ekuivokë.

(Ndërhyrje)

Po, urdhëroni!

KRYSUESJA: Urdhëroni zonja Tahiri!

MINISTRJA EDITA TAHIRI: Shikoni! Jo vetëm në këtë debat, por përgjithësisht, në debate fokusi është te marrëveshja. Mirëpo, fokusi edhe nuk është se çfarë po zgjidh kjo marrëveshje.

Ju lutem, mos shikoni vetëm numrat dhe marrëveshjet. Çka është rëndësia e marrëveshjes? Çka po bëhet me këtë marrëveshje? Po bën ndryshime të mëdha! Në çfarë kuptimi? Po i heq strukturat ilegale të Serbisë në Kosovë në fushën e drejtësisë! Kjo është e para bre!

Për të shtri sovranitetin në veri, ti më së pari duhet t'i zhbësh ato struktura.

(Ndërhyrje)

Armend! Dëgjo! Jo, nuk e di, por më dëgjo! Obligim ligjor, je duke folur, i yni a? E pra pse prej vitit 1999 deri në vitin 2011 ne nuk arritëm ta shuajmë...

(Ndërhyrje)

Shiko! Nuk është edhe kaq thjeshtë. Jo, nuk është, dhe kërkoj falje që po them kështu. Nuk është kaq thjeshtë. Dalja nga lufta, marrja e përkrahjes ndërkombëtare për shtetin, për lirinë, ndërhyrjet e ish okupatorit... Këto janë të gjitha procese të sfidave të pasluftës.

Unë besoj se askush s'e ka pritur që paslufta do të jetë një situatë me prerje qartë. Këto ishin sfidat tona. Na i bëri UNMIK-u, na i la UNMIK-u.

Ju kam thënë ndoshta se doktoratura ime merret me këtë punë. Pse? Sepse, jam shqetësuar. Jam shqetësuar se – u çlirua Kosova, Rezoluta 1244 i jepte kompetenca të qarta UNMIK-ut që të administrojë bashkë me vendorët në gjithë territorin e Kosovës, por UNMIK-u tolerojë strukturat paralele të Serbisë në shumë fusha, pra edhe në drejtësi, në veri të vendit.

Pra, nuk është një deklaram me ligj, a pa ligj. Është e lidhur me problemet komplekse dhe prandaj fokusohuni që Marrëveshja për drejtësi po i shuan këto struktura, i ka shuajtur, dhe këta njerëz po i marrim në institucione por në institucione përmes ligjeve.

Dhe, tani të ju lexoj kriteret, por para kriterëve ja po ua jap një pasqyrë se si do të duket përbërja etnike e Gjykatës.

Pra, pas procesit të integrimit dhe vendosjes së Gjykatës Themelore për regjionin e Mitrovicës do të ketë 140 shqiptarë, 138 serbë dhe 1 nga komuniteti, si duket RAI është këtu, po kjo nuk do të jetë pak, e thashë, dhe do të ketë angazhime shtesë të institucioneve që të rrisim përbërjen.

(Ndërhyrje)

Jo, të fola, ti regjistroj e pastaj flasim prapë.

Tani, ju thatë se kryetari i Gjykatës Themelore të jetë serb. A po?

(Ndërhyrje)

Më lejoni, vetëm një moment! Kosova i ka 7 gjykata themelore, dhe po të ishin të gjithë shqiptarë, a do të ishin prapë mono-etnike?

(Ndërhyrje)

Jo, le të jemi pak më fer. Të jemi pak më fer. Ne, vetë, kur e kemi ndërtuar shtetin dhe i kemi vënë themelet kushtetuese të shtetit, kemi thënë: shumica shqiptare do të respektojë minoritetet që janë pakicë në Kosovë.

Unë e di se shpesh është thënë – Kosova etnike, e Kosova nuk është multi-etnike. Dihet, me shumicë shqiptare dhe me një pakicë, më pak se 10%. Por, Kushtetuta e Kosovës vërtet është e avancuar në kuptimin e integritit të minoriteteve.

Tani, edhe një herë dëshiroj të përsëris – të gjitha marrëveshjet janë të publikuara. Formulimi i juaj ishte disa. Të gjitha janë pra të publikuara dhe kjo marrëveshje do të publikohet në momentin kur bëhet edhe dekretimi. Është proces i hapur dhe si të kryhet, ditën e dekretimit, do të jetë në ueb-faqe. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit! Urdhëroni, zonja ministre Tahiri!

MINISTRJA EDITA TAHIRI: Edhe për degët, sipas ligjit, janë katër dega, apo jo, ministresh?

Dhe unë, njihem mirë me ligjin, sepse tash po merrem me këtë marrëveshje.

(Ndërhyrje)

E tani, për kriteret. Sipas ligjit përkatës, këto kanë qenë kriteret që do duhej respektuar:

1. Kandidati të jetë shtetas i Republikës së Kosovës.
2. Të kenë diplomë të fakultetit juridik, të pranuar me ligjet e Kosovës.
3. Të kenë kaluar provimin e jurisprudencës të akredituar në pajtim me ligjin në fuqi në Kosovë.
4. Të kenë reputacion profesional dhe integritet moral;
5. Të mos kenë qenë të dënuar për vepër penale;
6. Të kenë së paku 3 vjet përvojë pune në fushën ligjore;

7. Të kenë kaluar provimin për gjyqtar, në përputhje me kushtet dhe procedurat e përcaktuara nga rregullorja e veçantë e miratuar nga këshilli përkatës.

E tash, ju e pyetje interesante që po kam edhe dëshirë të ju përgjigjem. Pyetja e juaj ishte – përvoja e tyre e punës nga periudha kur kanë punuar kundër rendit kushtetues të Kosovës.

Unë ju thashë se për t'i dhënë shans pra integritit të këtyre personave, jo vetëm të gjyqësisë, por në përgjithësi dhe për të konsoliduar sovranitetin shtetëror në veri të vendit ne kemi ndërmarrë edhe masë afirmative të shprehur në Ligjin për Amnisti.

Dhe, po ju them, nuk është Kosova e para që e ka bërë këtë. Unë ju përmenda Kroacinë në raport me serbët e Sllavonisë lindore, por mund të ju përmendi shumë raste që pas përfundimit të luftës procesi i riintegritit po ashtu bazohet në një politikë të amnistisë për t'i bërë njerëzit që të kthehen në sistem. Faleminderit!

KRYESUESJA: Faleminderit shumë zonja ministre Tahiri! Urdhëroni, zonja ministre Hoxha!

MINISTRJA DHURATA HOXHA: Shumicës së pyetjeve u përgjigje edhe ministrja Tahiri, por do të fokusohem për t'mos u përsëritur, dhe do të fokusohem në ato pyetjet të cilat kanë qenë specifikisht të drejtuara tek Ministria e Drejtësisë.

Njëra ndër pyetjet ka qenë për çështjen e komuniteteve tjera – sa i nënshtrohen provimit të jurisprudencës po mbesin jashtë.

Provimi i jurisprudencës organizohet 4 herë në vit, dhe të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës mund të aplikojnë, kurdo që i plotësojnë kushtet dhe ato kushte janë shumë publike sipas Ligjit të Provimit të Jurisprudencës. Pra, të gjithë u nënshtrohen dhe në mënyrë të barabartë atyre kushteve.

Tani, sa i nënshtrohen provimit – po mbesin jashtë. Si Ministri e Drejtësisë, me të vërtetë jemi të përkushtuar të kemi angazhim më të madh edhe të komuniteteve tjera, jo vetëm të komunitetit serb, dhe do të mundohemi që me gjithë praktikën dhe ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës ta inkurajojmë një angazhim edhe më të madh të komuniteteve në fjalë.

Këtu dua të ndërlidhem edhe me pyetjen se – çka do të ndodhë për sistemin noterial dhe përmbarues në veri. Në sistemin noterial në veri deri më tani nuk kemi pasur noter, për faktin se provimi i noterisë ende nuk është organizuar, kemi

sinjale se ka të interesuar. Dhe, në momentin që organizohet provimi noterial, pra prapë do të jetë sipas Ligjit mbi Noterinë, do të jenë kushtet e barabarta, nuk do të ketë trajtim special për askënd dhe kushdo që i plotëson kushtet të kalojë provimin e noterisë dhe atëherë do ta marrin licencën për noter.

Njëjtë është edhe për përmbaruesit, kurdo që organizohen provimet në kushte të barabarta, edhe qytetarët serbë, por edhe të komuniteteve të tjera, mund të aplikojnë dhe ne nuk krijojmë apo nuk i kemi të parapara me ligj standardet preferenciale që një komunitet të kalojë në mënyrë preferenciale, por kushdo që e kalon provimin, qofshin ata edhe qytetarët në veriun e Kosovës, do ta kalojnë, do të licencohen si përmbarues, pra gjithmonë, nëse i plotësojnë kushtet.

Çështja tjetër ishte – disiplinimi. Përgjegjësia disiplinore. Kush do t'i shkarkojë këta gjyqtarë apo prokurorë?

Edhe këtu, duhet të ritheksoj se ligjet e Republikës së Kosovës vlejnë në mënyrë të njëjtë për të gjithë. Pra, edhe disiplinimi edhe shkarkimi do të bëhet sipas ligjeve të aplikueshme dhe që janë në fuqi për Republikën e Kosovës. Pra, Këshilli Gjyqësor, Këshilli Prokurorial, mund të rekomandojë për secilin për secilin gjyqtar, pra qoftë ai gjyqtar shqiptar, serb apo i ndonjë komuniteti tjetër, qoftë ai prokuror serb apo i ndonjë komuniteti tjetër – njëjtë, pra si edhe për prokurorët shqiptarë i rekomandon për gjyqtar presidentit dhe pastaj merren masat tjera.

Pra, gjithçka është në pajtim me ligjin.

Dhe, dua të ritheksoj edhe këtë se asnjë ligj nuk ka ndryshuar apo nuk do të ndryshojë për të reflektuar marrëveshjen e drejtësisë. Pra, edhe ligjet që i përmenda në fillim – Ligjin për KGJK-në, KPK-në dhe përgjegjësitë disiplinore, janë ligje të cilat i parashohin tanimë dispozitat e reja në Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve ku e kemi përforcuar llogaridhënien, i reflektojmë vetëm këto.

Pra, asgjë nuk ka ndryshuar që të reflektojë implementimin e marrëveshjeve.

Një çështje tjetër, te rekrutimi i përgjithshëm, që e përmendi këtu edhe ministria, standardet dhe kriteret janë përcaktuar qartë me ligj dhe Këshilli Gjyqësor është i obliguar t'i respektojë, pra edhe çështjen për rekrutimin.

Kurse, sa i përket asaj çështjes specifike për provimin e jurisprudencës, se sa aplikojnë, sa e kalojnë provimin edhe në raport me komunitetet tjera.

Dhe, një mesatare se kandidat aplikojnë në një afat për provimin e jurisprudencës, është zakonisht 150 deri 200. Pra, këtu përfshihen shqiptarët, serbët dhe komunitetet tjera.

Flas vetëm për afatin e fundit, 150 vetë kanë aplikuar, 97 kanë kaluar. Do të thotë, 9 ishin që kanë kaluar nga komuniteti serb, 6 nuk kanë kaluar nga komuniteti serb.

Provimi, siç e dini, organizohet edhe sipas Ligjit për Jurisprudencës, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe.

Statistika tjera mund të ju sigurojmë.

(Ndërhyrje)

Po, edhe për gjyqtarë, kur ishte afati i shtatorit, 9 gjyqtarë kanë kaluar dhe kanë qenë diku 3, siç më duket, që nuk i kanë përmbushur kushtet dhe nuk kanë kaluar.

KRYESUESJA: Faleminderit shumë zonja Hoxha!

(Ndërhyrje)

Faleminderit shumë! Armend, ta përfundojmë mbledhjen dhe pastaj mund të flasim.

Faleminderit shumë zonja Tahiri për prezencën në Komision, për sqarimet apo për përgjigjet në pyetje.

Faleminderit shumë zonja Hoxha për prezencën në Komision.

Urojmë të na përgjigjeni kur të ju ftojme edhe herëve tjera dhe ndoshta ju ftojme pak më shpesh. Nganjëherë, po ndodh të mos jenë këtu, dhe ne duhet gjetur orarin kur janë këtu e me i ftuar ose të kemi agjenda. Prandaj ju inkurajojmë për punën e mëtijshme dhe keni përkrahjen e Komisionit ku mendoni se ne mund t'ju ofrojmë mbështetje, dhe le të na shkojë puna mbarë.

MINISTRJA EDITA TAHIRI: Faleminderit shumë, që na mundësuat të bisedojmë së bashku, sepse kjo marrëveshjeve më të rëndësishme, por edhe më të ndjeshme. Kjo u pa edhe nga pyetjet e parashtruara.

Ju falënderoj të gjithëve për pyetjet, të cilat më mundësuan që të sqarohem edhe më shumë, edhe për ju, Kuvendin dhe opinionin.

E po ashtu, dëshiroj të them se sa është i vështirë dialogu, për çka shpesh kam thënë se a bën edhe deputetët nganjëherë të na bashkëngjiten në ndonjë nga raundet.

Keni pasur rast të shihni një film, që ka qenë për momente nga negociatat, që nuk janë të regjisë, janë të gjallë, siç janë zhvilluar, por unë vërtet ju ftoj që ndonjëherë të jemi edhe bashkë vetëm për të përjetuar së bashku sfidat, vështirësitë por edhe suksesin, prandaj unë edhe një herë po them – suksesi ynë, si shtet në këtë dialog, ka qenë se nuk kemi lejuar asnjë marrëveshje që do t’na i ndryshonte ligjet.

Pra, secila marrëveshje të bëhet në pajtim me ligjet dhe Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Kuptohet, e kam parasysh që aty-këtu mund të janë bërë fleksibilitete, por me rëndësi është që ligjet dhe Kushtetuta janë mbrojtur.

Armend po më duhet të them – kërkoj falje, por pyetjet i kishit shumë të mira! Faleminderit!

KRYESUESJA: Edhe një herë, faleminderit për pjesëmarrje dhe kontributin tuaj! Mirë u pafshim në dëgjimet tjera publike!